



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1082 Prot.  
1

Tiranë, më 18 / 9 /2017

VENDIM

Nr. 88, datë 18 / 9 /2017

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, Z. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") ankimin nr. 1082 Prot., datë 04.08.2017, kundër Autoritetit Publik "Prokurorisë së Përgjithshme" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik"), me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

Ankuesi ka depozituar pranë Autoritetit Publik kërkesën për informacion si më poshtë:

- *Emrat e subjekteve deklaruese të kallëzuar penalisht nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, nga data 01.01.2016-03.07.2017, përfshirë edhe akuzat përkatëse për secilin subjekt deklarues, në formë elektronike.*
- *Emrat e punonjësve të proceduar sipas ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave, që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", nga fillimi i zbatimit të ligjit deri më 05.07.2017.*

Autoriteti Publik me shkresën nr. 768/2 Prot., datë 26.07.2017 ka argumentuar refuzimin e dhënies së informacionit të kërkuar, bazuar në ligjin procedural penal nr.7905, datë 21.03.1995. Sipas këtij ligji, informacioni që përmban dosja hetimore nuk përbën informacion publik në kuptim të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, por informacion të mbledhur për nevoja të procedimit penal, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, që përfshijnë si subjekte të procedimit penal ashtu edhe informacione e të dhëna të lidhur me persona të tretë. Rregullat dhe legjitimiteti për aksesin në këtë lloj informacioni, përcaktohen në Kodin e Procedurës Penale, ligj i cili në hierarkinë e ligjeve prevalon mbi ligjin për të drejtën e informimit.

Gjithashtu argumentohet se, bazuar në pikën 2 të nenit 9 të ligjit 97/2016, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, *“Prokurorisë nuk i lejohet të bëjë publike ose t’u japë personave të tretë të dhëna që dëmtojnë çështjen në proces hetimi apo gjykimi, që cenojnë dinjitetin dhe jetën private të personave, të drejtat e të miturve, si dhe të dhëna me karakter konfidencial ose të rezervuar”*.

Autoriteti Publik ka cituar gërmën b) të pikës 2 të nenit 17 të ligjit “Për të drejtën e informimit” si shkak ligjor për kufizim në dhënien e informacionit të kërkuar dhe në përfundim e drejton kërkuuesin tek Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI) si institucioni që ka vënë në lëvizje organin e Prokurorisë.

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Ankuesi pretendon se argumentet e dhënë nga Autoriteti Publik nuk qëndrojnë, konkretisht për këto arsye:

1. Në kërkesë nuk kërkohet asnjë informacion apo e dhënë mbi trajtimin e kallëzimeve penale, që mund të cenojnë hetimet, por vetëm subjektet dhe akuzat e pretenduara nga një tjetër organ.
2. Informacioni i kërkuar nuk cenon sekretin hetimor, pasi subjektet e kallëzuar janë në dijeni të kallëzimit dhe si të tillë ata janë thirrur për sqarime nga institucioni që ka bërë kallëzimin.
3. Autoriteti publik pretendon se informacioni cenon jetën private dhe dinjitetin e personave, por personat e kallëzuar për shkelje të ligjit janë subjekte që deklarojnë pasurinë, mbajnë funksione të larta drejtuese, për të cilët ka një interes të madh publik.
4. Autoriteti publik, në rastin konkret, operon me dy standarde, duke shkelur ligjin për të drejtën e informimit, pasi në praktika të mëparshme, ka dhënë informacion, edhe mbi trajtimin e kallëzimeve të bëra nga ILDKPKI.
5. Duke qenë i pasigurt dhe duke mos pasur një bazë ligjore, autoriteti publik, këshillon që kërkesa për informacion ti dërgohet ILDKPKI, i cili ka vënë në lëvizje Prokurorinë.



Pas shqyrtimit të ankesës dhe konsultimit të legjislacionit përkatës rezulton se, informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i cili përcakton se: “Informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

Autoriteti Publik nuk ka përmbushur detyrimin për dhënie informacioni sipas kërkesës, megjithëse disponon informacionin e kërkuar.

Informacioni mund të kufizohet nga e drejta për informim, vetëm në rast se shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë në *hetimin dhe ndjekjen penale*.

Në rastin konkret nuk kërkohet informacion i mbledhur për nevoja të procedimit penal, por informacion i përpiluar nga një Autoritet Publik (ILDKPKI) e për këtë arsye nuk mund t’i nënshtrohen përcaktimeve të Kodit të Procedurës Penale.

Informacioni i kërkuar lidhet me persona subjekte të ligjit 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe nëpunësve publikë” dhe ligjit ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave, që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, për të cilët ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij.

Për të dhëna të tjera apo që lidhen me persona të tretë, Autoriteti Publik duhet të zbatojë kufizimet e përcaktuara në gërmën a) të pikës 1 të nenit 17, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” si dhe nenet 5, 6 dhe 7 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar duke kryer anonimizimin e të dhënave personale.

Në vijim të këtij arsyetimi, vlen të theksohet gjithashtu se në pikën 6 të nenit 17, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, përcaktohet se: “nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”.

Komisioneri ka mbajtur të njëjtin qëndrim edhe në Vendimet nr. 48, datë 13.03.2017 dhe nr. 49 datë 15.03.2017, për çështje të ngjashme, ku ka urdhëruar dhënien e informacionit me kufizimet përkatëse.

Sugjerimi që Autoriteti Publik i ka dhënë kërkuarit, në mënyrë që ky i fundit t’i drejtohet ILDKPKI-së, nuk qëndron dhe është në kundërshtim me përcaktimet e ligjit. Bazuar në pikën 2 të nenit 12, të ligjit “Për të Drejtën e Informimit”, Autoriteti Publik në qoftë se konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuarin.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se informacioni i kërkuar është informacion publik,

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkzionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Z. \_\_\_\_\_ ndaj Autoritetit Publik "Prokuroria e Përgjithshme", Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5, të nenit 24, nenit 25, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18, të ligjit nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

### V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Z. \_\_\_\_\_ me Nr. 1082 Prot., datë 04.08.2017, ndaj Autoritetit Publik "Prokuroria e Përgjithshme" me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik "Prokuroria e Përgjithshme", për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar sipas objektit të kërkesës, *emrat e subjekteve deklaruese të kallëzuar penalisht nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, nga data 01.01.2016-03.07.2017, përfshirë edhe akuzat përkatëse për secilin subjekt deklarues, në formë elektronike; emrat e punonjësve të proceduar sipas ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave, që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", nga fillimi i zbatimit të ligjit deri më 05.07.2017, brenda datës 25.9.2017.*
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
4. Ky vendim u dha sot me datë 18.9.2017.

**KOMISIONERI**  
*Besnik Dervishi*  
**Besnik Dervishi**

